

KOMUNIKATË PËR MEDIA

14 shkurt 2008

AKM reagon ndaj keqinformimit publik të botuar në gazetën “Express” me titull “Në AKM keqpërdorime me bollëk”

Prishtinë - Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) shpreh indinjatën e thellë në lidhje me artikullin e botuar në gazetën Express të datës 14 Shkurt 2008 me titull “Në AKM keqpërdorime me bollëk” dhe dëshiron të informoj publikun si vijon.

Auditori i jashtëm nuk ka konstatuar kurrfarë keqpërdorimesh gjatë auditimit të fondeve të mirëbesimit dhe çdo e gjetur e rëndësishme nga auditori i jashtëm është korrigjuar nga menaxhmenti i AKM-së gjatë procesit të auditimit.

Auditori i jashtëm, në raportin i cili së shpejti do të publikohet, ka dhënë një opinion pa rezervë për AKM-në lidhur me atë se pozita financiare e fondeve të privatizimit në mirëbesim dhe bilanci i fondeve të privatizimit si dhe qarkullimi i parasë në fondet e privatizimit nga viti 2003 e deri ne Shtator 2007, në të gjitha aspektet materiale, është në përputhshmëri me kornizën ligjore dhe rregullative në fuqi.

Për më tepër, auditori i jashtëm ka konstatuar se kontrollet e brendshme janë dizajnuar nga AKM-ja në mënyrë adekuate dhe operojnë me efikasitet mbi procesin e menaxhimit financiar dhe të menaxhimit të parasë, sistemin e barazimit si dhe procedurat financiare të përdorura nga AKM-ja për të siguruar proces transparent dhe të saktë lidhur me fondet e privatizimit në mirëbesim.

Kjo do të vërtetohet posa Zyra e Auditorit Gjeneral të Kosovës ta publikoj raportin në fjalë.

AKM dëshiron të njoftoj publikun se pretendimet e gazetës Express për keqpërdorime të 1.5 milion EUR të fondeve të privatizimit janë tendencioze dhe nuk përkojnë me raportin e auditimit dhe për më tepër qartë e portretizojnë mungesën e profesionalizmit gazetaresk në Express.

Për këtë arsye, AKM kërkon nga gazeta Express që ta korrigjoj artikullin në fjalë për hir të informimit të drejtë të qytetarëve (që është detyrë e gazetës) dhe të kërkoj falje për dezinformimin e publikut me të cilën gjë ka dëmton rëndë imazhin e AKM-së dhe të stafit të saj.

Përndryshe AKM do të paraqes këtë çështje para Komisionerit të Mediave në Kosovë.